

**HAMIT KABA****KONFERENCA E SIGURIMIT DHE E BASHKËPUNIMIT  
EVROPIAN (KSBE): NJË SHANS I HUMBUR PËR SHQIPËRINË**

Konferenca e Sigurimit dhe e Bashkëpunimit Evropian (KSBE)<sup>1</sup>, e njohur edhe si Konferenca e Helsinkit, ka qenë një ngjarje e rëndësishme për vendet evropiane, SHBA e Kanadanë, dhe në përgjithësi për mbarë botën. Ajo shënoi një përpjekje për të zhvilluar dialogun ndërmjet Evropës Lindore e Perëndimore, duke shënuar pikën më të lartë të shkrirjes së akujve, deri në vitin 1979 gjatë Luftës së Ftohtë<sup>2</sup>. Ajo, njohu de-facto kufijtë e Evropës së dalë nga Lufta e Dytë Botërore; zbehu barrierat politike dhe ekonomike të vendosura pas saj; forcoi tendencën e respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe të besimit, si dhe ndikoi pozitivisht në procesin e Detantës (ulje tensioni) të viteve 70<sup>3</sup>. Efektet e vendimeve të saj u ndjenë në vitet pasardhëse. Ata shërbyen si truall mbështetës për lëvizjet disidente që lindën në vendet ish komuniste, të tilla si “Karta 77”

---

<sup>1</sup> Konferenca për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian i filloi punimet më 3 korrik 1973 në Helsinki dhe i vazhdoi ato më tej në Gjenevë (18 shtator 1973-21 korrik 1975), për t’i përfunduar po në Helsinki, më 1 gusht 1975. Në të morën pjesë përfaqësues të lartë të Austrisë, Belgjikës, Bullgarisë, Kanadasë, Qipros, Çekosllovakisë, Danimarkës, Finlandës, Francës, Republikës Demokratike Gjermane, Republikës Federale Gjermane, Greqisë, Selisë së Shenjtë (Vatikanit), Hungarisë, Islandës, Irlandës, Italisë, Lihteishteinit, Luksemburgut, Maltës, Monakos, Holandës, Norvegjisë, Polonisë, Portugalisë, Rumanisë, San Marinos, Spanjës, Suedisë, Zvicrës, Turqisë, Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Jugosllavisë. Konferenca miratoi “tre shporta”: të parën për sigurinë, të dytën për bashkëpunimin ekonomik dhe të tretën, për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore të tij. Shih: <http://www.hri.org/docs/Helsinki75.html>, më 18.08.2009. Në vitin 1994, Konferenca e Sigurimit dhe e Bashkëpunimit Evropian (KSBE) ndryshoi emrin dhe u quajt: Organizata e Sigurimit dhe e Bashkëpunimit në Evropë (OSBE). Shqipëria u pranua në KSBE në qershor 1991.

<sup>2</sup> Jan Palmowski, *Oxford Dictionary of Contemporary World History from 1900 to the Present Day*, New York: Oxford University Press Inc., 2008, p.155.

<sup>3</sup> <http://www.hri.org/docs/Helsinki75.html>, 18.08.2009 (Konferenca mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, Akti Final, Helsinki, 1 gusht 1975).

në Çekosllovakia, apo “Lëvizja Solidarnost” në Poloni. “Konferenca e Sigurimit Evropian, shkruan Henry Kissinger, luajti kështu një rol të rëndësishëm të dyfishtë: në fazat e saj përgatitore, ajo moderoi qëndrimin sovjetik në Evropë dhe, më pas, ajo shpejtoi përmbysjen e Perandorisë Sovjetike”<sup>4</sup>. Konferenca për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian ishte i vetmi forum që funksioni në intervale të rregullta ndërmjet shteteve komuniste e kapitaliste. Sesione të këtij forumi u zhvilluan në Beograd (1977-1978), në Madrid (1980-1983), Vjenë (1986-1990) dhe në Helsinki.

Konferenca e Helsinkit nuk ishte një akt i menjëhershëm, por një proces i tërë, i cili filloi në vitin 1969 dhe përfundoi në vitin 1975. Finalizimi i saj më 1 gusht 1975, u arrit pas një pune përgatitore disavjeçare (1969-1973), dhe pas sqarimit të mëdyshjeve që kishin, sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga administrata e Niksonit<sup>5</sup>. Akti final i Konferencës së Helsinkit u përfundua nga administrata e presidentit Ford, pasi Niksoni, pas skandalit të “Watergate” kishte dhënë dorëheqjen. “Në fillim, kur u propozua mbajtja e Konferencës, kujton ish-Sekretari amerikan i Shtetit, Henry Kissinger, ne menduam, se ishte një manovër e sovjetikëve pas pushtimit të Çekosllovakisë nga trupat sovjetike, që të hynte përsëri në skenë, të bëhej përsëri lojtare. Ne, menduam gjithashtu, se ishte një manovër për të minuar NATO-n. Kështu që, në fillim i rezistua idesë së një Konference për Sigurinë”<sup>6</sup>.

Në Perëndim u zhvillua një debat i ashpër, pasi disa e akuzonin botën e lirë se po i jepte legjitimitet hegjemonisë sovjetike në Evropën Lindore, duke pranuar kufinj të pas Luftës së Dytë Botërore<sup>7</sup>. Por, falë këmbënguljes së amerikanëve u arrit që në aktin final të Konferencës së Helsinkit të përfshiheshin dy klauzola të rëndësishme: njohjen e kufijve të Pasluftës, po të shoqëruar me detyrimin për të mos i ndryshuar ata me forcë, dhe më të rëndësishmen, miratimin e dispozitave mbi të drejtat e njeriut, të përfshira në “shportën e tretë”. Për herë të parë në histori, ky problem do të trajtohej si shqetësim legjitim i politikës së jashtme të

---

<sup>4</sup> Henry Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1999, f.760.

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 758.

<sup>6</sup> Zëri i Amerikës, [www.zeriamerikes.com/content/a-30-2005-08-01-voa-7-855/9962/419291.html](http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2005-08-01-voa-7-855/9962/419291.html).

<sup>7</sup> H. Kissinger, *Diplomacia...*, f. 760.

vendeve pjesëmarrëse, dhe do të kontribuonte në shkërmoqjen nga brenda të regjimeve komuniste të Evropës Lindore, në ligjësimin dhe dhënien “frymë” të disidentëve dhe disidencës në shtete ish-komuniste të Evropës. SHBA e mbështetën idenë e mbajtjes së Konferencës dhe e pasuruan më tej përmbajtjen e saj duke pasur në konsideratë interesat e tyre të gjera globale, interesat e vendeve evropiane, si dhe synimin për të ruajtur balancat ushtarake ndërmjet tyre dhe BRSS në Evropë.

Ideja për mbajtjen e një konference sigurie në Evropë, u artikulua për herë të parë nga BRSS, në takimin e vendeve komuniste të Evropës në Bukuresht, në vitin 1966. Por, ajo u rimor sërish në vitet pasardhëse në takimet e nivelit të lartë, të krerëve komunistë të vendeve të Evropës Lindore, si në Konferencën e Karlo-Vivarit (prill 1967), në Konferencën e ministrave të Punëve të Jashtëm të vendeve të Traktatit të Varshavës në Budapest (dhjetor 1967), në Pragë (nëntor 1967), në Moskë (dhjetor 1969), në Budapest (qershor 1970) dhe në Berlin në dhjetor të këtij viti<sup>8</sup>. Spektri i problemeve që do të trajtonte konferenca e pretenduar në vitet 1966-1967, kishte të bënte me zhvillimin e kontakteve dhe të bashkëpunimit në të gjitha fushat, ndërmjet shteteve të Lindjes dhe të Perëndimit, likuidimin e blloqeve dhe bazave ushtarake në territoret e shteteve evropiane, pakësimin e forcave të armatosura të dy shteteve gjermane, krijimin e zonave të demilitarizuara etj. Por, në vitin 1968, pas pushtimit të Çekosllovakisë nga trupat e Traktatit të Varshavës, ideja e sigurimit evropian u fokusua kryesisht tek të hequrit dorë nga përdorimi i forcës dhe i kërcënimeve për përdorimin e tyre në marrëdhëniet ndërmjet shteteve evropiane.

Fillimisht sovjetikët u shprehën për një konferencë ndërevropiane, pa pjesëmarrjen e SHBA dhe Kanadasë. Pas konferencës së Budapestit të qershorit 1970, problemi i thirrjes së një konference evropiane u bë objekt pothuajse i çdo takimi të rëndësishëm, ndërmjet vendeve-anëtare të Traktatit të Varshavës<sup>9</sup>. “Ky proces diplomatik i përbindshëm, si do ta cilësonte Henry Kissinger, - erdhi si rezultat i ndjenjës së pasigurisë së Moskës, të rrënjosur thellë, dhe etjes së saj të pashuar për legjitimitet..., ajo kërkonte ... një formulë që mund ta përdorte për bekimin e përvehtësimeve të saj. Në këtë kuptim, me anën e Konferencës së

<sup>8</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1971, Dosja (më tej: D.) 673, fl.1.*

<sup>9</sup> *Po aty, fl. 4.*

Sigurimit Evropian, Brezhnjevi zëvendësoi traktatin e paqes me Gjermaninë...”<sup>10</sup>. Një ndër qëllimet e BS ishte edhe mundësia e dobësimit të NATO-s dhe e rolit të saj në Evropë, duke kërkuar tërheqjen e trupave amerikane nga Evropa, qëllim të cilin ai nuk e arriti dot. Propozimin sovjetik për mbajtjen e Konferencës së Sigurimit Evropian, Brezhnievi do t’ia servirte Shtëpisë së Bardhë me termat: “vera që ofrohet nga sovjetikët, duhet gjykuar jo nga pamja, por nga shija që ka”<sup>11</sup>. Ideja e mbajtjes së një konference për sigurinë në Evropë u diskutua edhe ndërmjet përfaqësuesit të Selisë së Shenjtë, Agostino Casaroli (sekretar i Këshillit për Çështjet Publike të Kishës) dhe ministrit të Jashtëm të BS, Gromiko në vitin 1970 dhe në vitin 1971<sup>12</sup>. Vendet satelite të BS nga ana e vet e shihnin konferencën si mundësi për të fituar më shumë pavarësi nga Moska.

Duhet përmendur se konkretizimi i Konferencës së Sigurimit Evropian u mundësua pas diskutimeve dhe zgjidhjes së problemeve madhore, që shqetësonin të dy palët<sup>13</sup>. Megjithëse, ideja për mbajtjen e një konference kushtuar sigurisë evropiane ishte përgjithësisht tërheqëse, vendet perëndimore dhe veçanërisht SHBA u treguan të rezervuara ndaj saj. Me qëllim që të arrihej një paqe e qëndrueshme në Evropë u hodh ideja, që mbajtjes së konferencës duhej t’i paraprinin zhvillimet e

<sup>10</sup> H. Kissinger, *Diplomacia ...*, f. 758; Siç dihet, pas Luftës së Dytë Botërore nuk u arrit të nënshkruhej një traktat paqeje me Gjermaninë. Lindja e dy shteteve gjermane, përkatësisht RFGJ dhe RDGJ krijoi një realitet të ri, por të palegjitimuar bashkërisht nga të mëdhenjtë.

<sup>11</sup> *AMPJ*, V. 1971, D. 673, f. 9.

<sup>12</sup> *Po aty*, f. 6; <http://www.hri.org/docs/Helsinki75.html>

<sup>13</sup> Në vitet 1970-1973 u arritën disa marrëveshje të rëndësishme, që i hapën rrugën përfundimisht thirrjes së Konferencës së Helsinkit: së pari, Traktati i Moskës (gusht 1970), sipas të cilit RFGJ do të njihte kufirin Oder-Neisse dhe kufirin e vet me RDGJ. BS premtoi të hapte negociatat për normalizimin e situatës në Berlinit Perëndimor; në dhjetor 1970 u firmos marrëveshja e Varshavës ndërmjet RFGJ dhe Polonisë, sipas të cilës RFGJ do të njihte kufirin me Poloninë, ndërsa Polonia do të lejonte gjermanët etnikë të mbetur në Poloni, që të ktheheshin në RFGJ; katër të mëdhenjtë pranuan në shtator 1971 statusin e Berlinit Perëndimor, që më vonë u shoqërua me masa të tjera. Bundestagu i RFGJ në maj 1973 vendosi të njohë RDGJ, dhe si pasojë të dy vendet u pranuan në Kombet e Bashkuara. Së fundi, në dhjetor 1973 u firmos traktati i Pragës ndërmjet Çekosllovakisë dhe RFGJ dhe pastaj marrëdhëniet diplomatike ndërmjet tyre. Shih:

<http://usa.usembassy.de/etexts/ga5-710903.htm>, më 24 gusht 2009.

bisedimeve bilaterale apo multilaterale, të cilat do të shërbenin si garanci për të arritur disa masa drejt çarmatimit apo kontrollit të armatimeve në Evropë. Kjo tendencë u bë më e qartë, pas takimeve të vendeve anëtare të Këshillit të NATO-s, në dhjetor 1969, në maj 1970 dhe në Lisbonë në qershor 1971.

SHBA dhe vendet perëndimore vendosën 4 kushte përpara sovjetikëve: pjesëmarrjen e Shteteve të Bashkuara dhe të Kanadasë në konferencën e ardhshme; arritjen e një marrëveshjeje për Berlinin, ndërmjet katër të mëdhenjve (SHBA, Britanisë së Madhe dhe Francës nga njëra anë dhe BS nga ana tjetër)<sup>14</sup>; zhvillimin e bisedimeve për pakësimin e ndërsjelltë dhe të ekuilibruar të forcave të armatosura; si dhe futjen në rendin e ditës të problemit të lirisë së qarkullimit të lirë të njerëzve dhe ideve<sup>15</sup>. Vendet e Lindjes i pranuan propozimet perëndimore në takimin e Budapestit të qershorit 1970<sup>16</sup>. Dritën jeshile për pjesëmarrjen e vendeve të Perëndimit në këtë iniciativë e hapi samiti i NATO-s, i mbajtur në Lisbonë në qershor 1971, pasi administrata e Niksonit kishte parashtruar kushtet e saj, duke shpresuar që BS do ta moderonte qëndrimin e tij. Pas kësaj periudhe të dy grupimet ecën në rrugën e mirëkuptimit, por edhe të lëshimeve ndaj njëri tjetrit.

Francezët në parim e mbështetën idenë e mbajtjes së një konference të sigurimit evropian, ndonëse nuk u treguan entuziaste ndaj saj, por nuk qenë aq skeptik sa amerikanët. Ky qëndrim i saj e kishte burimin tek politika e saj e përgjithshme, dhe tek mundësia për të fituar kohë, për të njohur më mirë manovrimet sovjetike. Në fakt, pushtimi i Çekosllovakisë e kishte pakësuar besimin e francezëve ndaj BS. Ndërsa sovjetikët flisnin për largim të amerikanëve nga Evropa, francezët kundërpërgjigjeshin duke thënë se, amerikanët ishin tërhequr nga Franca, ndërsa kjo nuk kishte ndodhur me trupat sovjetike në Çekosllovakia.

Nga ana e vet, Republika Federale Gjermane e mbështeti idenë e mbajtjes së konferencës, por kërkoi që paraprakisht të diskutohej dhe zgjidhej problemi i Berlinit Perëndimor.

Rol të rëndësishëm për përgatitjen, organizimin dhe realizimin e konferencës kanë pasur veçanërisht qeveritë e Finlandës dhe të Austrisë.

---

<sup>14</sup> Germany, a Country Study, Federal Research Division, Library of Congress, 1966, p. 107.

<sup>15</sup> Jan-Baptiste Duroselle, Andre Kaspi, *Historia e Marrëdhënieve Ndërkombëtare*, Vëllimi II, vendi: "Liria", 2011, f. 510.

<sup>16</sup> AMPJ, V. 1971, D. 673, fl. 4.

Vendet perëndimore si Finlanda, Austria, Suedia, Norvegjia etj., qenë të gatshme të fillonin procesin, pa vënë ndonjë kusht paraprak për zhvillimin e konferencës.

Shqipëria, ndonëse u ftua në mënyrë të rregullt nga vendet iniciatore dhe i ndoqi me vëmendje të gjitha hapat paraprake që çuan në thirrjen e Konferencës së Helsinkit (1973-1975), nuk u solidarizua ndonjëherë me këtë ide, dhe nuk mori pjesë as në takimet përgatitore dhe as në mbledhjen themeluese të saj. Arsytet e këtij qëndrimi, të cilat do të trajtohen e shpjegohen më poshtë, duhen kërkuar në radhë të parë tek politika dyshuese e regjimit shqiptar ndaj SHBA dhe BS, si dy liderët e grupimeve përkatëse gjatë Luftës së Ftohtë, tek frika e saj ndaj mundësisë së pentrimt apo ndërhyrjeve të dy superfuqive në problemet e brendshme të vendit, tek solidarizimi me politikën kineze, e cila e shihte veten të rrezikuar nga vendimet e Konferencës, e cila do të zhvendoste tensionet dhe konfliktet nga Evropa në Azi. Në mënyrë të veçantë, për udhëheqjen shqiptare paraqiste rrezik “shporta e tretë,” e cila kishte të bënte me kërkesat për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Pranimi dhe zbatimi i tyre në Shqipëri mund të sillte lindjen e lëvizjeve disidente dhe të disidencës brenda vendit, duke dëmtuar kështu stabilitetin e pushtetit komunist në vend. Sidoqoftë, udhëheqja shqiptare u kap fort pas qëndrimit të Kinës ndaj kësaj konference, e cila e konsideronte situatën e stabilizuar në Evropë, si rrezik për transferimin e konfliktit në rajone të tjera, dhe veçanërisht lënies dorë të lirë veprimeve agresive të BS ndaj Republikës Popullore të Kinës<sup>17</sup>.

Fakti që shteti shqiptar nuk mori pjesë në Konferencën e Helsinkit, në të cilin u përfshinë të gjitha vendet evropiane, (përveç Andorrës), është një shtysë më shumë për të hedhur dritë mbi këtë çështje të patrajtuar më parë. Sidoqoftë, mospjesëmarrja e Shqipërisë në Konferencën e Helsinkit, nuk ishte ndonjë akt i veçuar për politikën shqiptare, përkundrazi e kundërta do të kishte qenë risi për të. Në vitet 70, udhëheqja shqiptare kishte refuzuar dhe kishte bërë objekt të kritikës së saj, të tjera ngjarje të tjera të rëndësishme të politikës botërore. Ajo kishte paragjykuar “detantën” si proces të iniciuar nga dy superfuqitë - BRSS dhe SHBA;

---

<sup>17</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/ Arkivi i Partisë (më tej: AP), Viti (më tej: V.) 1971, Dosja (më tej: D.) 5, fl. 13. Nga biseda e Enver Hoxhës me ambasadorin e RP të Kinës në Shqipëri Lin Xhen Hua, më 30 shtator 1971.

marrëveshjen SALT; përpjekjet për afrim të dy shteteve gjermane - RFGJ dhe RDGj; marrëveshjet e RFGJ me Poloninë dhe Çekoslovakinë për njohjen e kufijve të pasluftës; marrëveshjen e katër Fuqive të Mëdha për Berlinin Perëndimor; politikën e Vili Brand-it, të njohur si “Ost Politika” etj. Në fillim të viteve 70-të qeveria shqiptare kishte refuzuar propozimet e SHBA, Britanisë së Madhe, RFGJ dhe Japonisë për të vendosur marrëdhënie diplomatike me vendin tonë<sup>18</sup>.

### **Qëndrimi i udhëheqjes shqiptare gjatë etapës përgatitore të KSBE**

Qeveria shqiptare u njoh për herë të parë zyrtarisht, me kërkesën e qeverisë finlandeze për mbajtjen e Konferencës për Sigurim dhe Bashkëpunimin në Evropë, përmes memorandumit të qeverisë finlandeze, që ju drejtua asaj, qeverive të Evropës dhe Shteteve Bashkuara të Amerikës, më 14 maj 1969<sup>19</sup>. Qeveria finlandeze kërkonte nga këto shtete, që ato të aktivizoheshin si subjekte të pavarura, për krijimin e kushteve të nevojshme për mbajtjen e një konference për sigurimin e kontinentit evropian. Në fakt, qeveria shqiptare nuk qëndroi indiferente ndaj këtij propozimi, por ajo ngarkoi ambasadën shqiptare në Pragë (Çekoslovakia), që të njihej më tej me burimin e kësaj iniciative. Në përgjigjen e ardhur nga Praga, qeveria shqiptare do të informohej se, iniciativën për thirrjen e kësaj konference e kishin marrë sovjetikët. Ideja ishte dhënë nga kryeministri i BRSS, Kosigin, në qershor 1966, gjatë vizitës së tij në Finlandë, ndërkohë që më 7 maj 1969 qeveria finlandeze do ta paraqiste këtë ide në rrethet diplomatike. Më 24 nëntor 1970, qeveria finlandeze u dërgoi një memorandum të dytë qeverive evropiane, qeverisë amerikane dhe asaj të Kanadasë, duke sugjeruar që të fillonin konsultimet paraprake në nivel bilateral, për të mundësuar organizimin në Helsinki, të një mbledhjeje përgatitore shumëpalëshe, të emërtuar më vonë “salloni i ambasadorëve”, për shkak të pjesëmarrësve në të, të ambasadorëve të shteteve evropiane<sup>20</sup>. Është e vështirë të hasësh ndonjë takim të rëndësishëm, të mbajtur në Finlandë gjatë këtyre viteve me përfaqësuesit e shteteve të tjera evropiane, nga Lindja apo Perëndimi, në

<sup>18</sup> Hamit Kaba, “Politika e SHBA ndaj Shqipërisë në vitet 70 dhe reflektimi i saj në NATO”, *Studime Historike*, nr. 3-4, Tiranë: 2008, f. 12

<sup>19</sup> *AMPJ*, V. 1969, D. 472, f. 8-9.

<sup>20</sup> *Po aty*, V. 1971, D. 673, f. 28-29.

të cilin të mos jetë përmendur edhe Konferenca e ardhshme e Sigurimit evropian. Roli i Finlandës, si një shtet katalizator për thirrjen e një konference për sigurimin evropian, lidhej me pozitën e saj si një shtet i vogël e neutral, në kufi me BS, por i pa rreshtuar në blloqe, por edhe me aftësinë e qeverisë finlandeze, për të shfrytëzuar momentin e përshtatshëm në marrëdhëniet Lindje Perëndim, të krijuar pas propozimeve të BS.

Rol aktiv në procesin e nxitjes dhe mbrojtjes së idesë së mbajtjes të një konference të tillë ka pasur edhe qeveria e Austrisë. Kjo qeveri në korrik 1970, u paraqiti qeverive të 32 vendeve, një memorandum, i cili kërkonte që të organizohej një takim në nivel ekspertësh, i cili do të merrej me përgatitjen e Konferencës së Sigurimit Evropian. Në këtë memorandum vihej theksi tek roli i shteteve të vegjël të Evropës dhe i pjesëmarrjes së tyre mbi baza demokratike dhe barazie, në zgjidhjen e problemeve të sigurisë në Evropë. Shtetet e vegjël të Evropës, nuk e konsideronin të dobishme diskutimin e problemeve të sigurisë në Evropë vetëm ndërmjet dy blloqeve të mëdhenj, NATO-s dhe Traktatit të Varshavës, sepse një metodë e tillë, sipas tyre do të kontribuonte në ndarjen e mëtejshme të Evropës dhe në dobësimin e identitetit të kombeve të vegjël.

Qeveria finlandeze ngarkoi diplomatin Enkel, si ambasador shëtitës të saj, që të kontaktonte dhe bënte sondazhe në kryeqytetet evropiane, për të parë jehonën e idesë së hedhur në tavolinë dhe shkallën e solidarizimit të qeverive të ndryshme me të.

Qeverisë shqiptare, sikurse edhe qeverive të tjera të Evropës iu bënë të njohura të gjitha memorandumet e qeverisë finlandeze, austriake etj. Qeveria shqiptare kërkoi të informohej më tej për këtë propozim, duke dashur të mësonte se si kishin reaguar qeveritë e vendeve evropiane ndaj tij. Për këtë qëllim ajo aktivizoi shërbimin e vet diplomatik në Evropë. Interesi më i madh i saj kishte të bënte me shkallën e përfshirjes të të dy superfuqive, SHBA dhe BRSS. Qeveria shqiptare nuk u shpreh zyrtarisht për qëndrimin e saj, ndonëse konsideratat e udhëheqjes shqiptare, të paraqitura në ambiente të ndryshme kishin qenë negative, që në periudhën përgatitore të saj. Në përcaktimin e politikës zyrtare të udhëheqjes shqiptare ndaj KSBE do të ishin përcaktues dhe me peshë të madhe faktorë të tillë si: qëndrimi i udhëheqjes komuniste të Republikës Popullore të Kinës; roli i SHBA dhe BRSS në KSBE; përmbajtja e saj etj.

Nga dokumentet që zotërojmë, të krijohet ideja se qëndrimi zyrtar i udhëheqjes shqiptare u formua nën ndikimin direkt të udhëheqjes kineze.

Kjo e fundit kishte pasur takime të rëndësishme edhe me Çaushekun e Titon . Në komunikatën kinezo-rumune, të botuar në përfundim të vizitës së Çaushekut në Kinë, më 9 qershor 1971, në lidhje me KSBE do të theksohej se, “pala kineze shpreh përkrahjen e saj për këto veprimtari dhe, çmon se për të ruajtur paqen dhe sigurimin, popujve evropianë, u duhet të luftojnë me vendosmëri imperializmin dhe politikën e kontrollit e të diktatit”<sup>21</sup>. Për udhëheqjen kineze, nuk mund të flitej për sigurim evropian, në kushtet kur në Evropë kishte trupa sovjetike dhe amerikane. Largimi i trupave të këtyre dy shteteve nga Evropa ishte, sipas tyre kusht i domosdoshëm, për të siguruar pavarësinë e shteteve të saj.

Enver Hoxha, ju përmbajt idesë kineze se Bashkimit Sovjetik i interesonte sigurimi evropian “me qëllim që të sigurojë krahët në Evropë, për t’i pasur duart e lira kundër Kinës. Partia jonë, përmendte Enver Hoxha, bën një politikë kundër afrimit të Bashkimit Sovjetik me Gjermaninë e Bonit, kundër “sigurimit evropian” dhe dënon politikën revizioniste të Çaushekut, si një politikë koniunkturash.... Të jesh për sigurimin evropian, vazhdonte ai më tej, do të thotë të mbrosh sigurimin sovjetik në Evropë dhe në të njëjtën kohë, t’i bësh qejfin Gjermanisë Perëndimore, për të marrë kredi prej saj”<sup>22</sup>. Sjellja politike e qeverisë shqiptare kundër sigurimit evropian, mbetej një akt i pakuptueshëm për shtetet evropiane në përgjithësi, por veçanërisht e pakuptueshme ishte ajo për disa shtete të paangazhuar në blloqet ushtarake të kohës, si Finlanda, Austria etj. Në të kundërt për politikën e këtyre vendeve pranimi i idesë së sigurimit evropian do të ishte pengesë për të frenuar e ndaluar ndonjë sulm të mundshëm të BRSS ndaj RP të Kinës.

Në takimin e 11 dhjetorit të vitit 1971 me delegacionin tregtar kinez, Enver Hoxha do të deklaronte sërish se, “sigurimi evropian do të thoshte paqe në Evropë, por që ne, popujt e këtij kontinenti, të mbetemi robër të sovjetikëve dhe të amerikanëve, do të thotë t’u krijojmë qetësi sovjetikëve për të pasur dorë të lirë kundër Kinës, ...sovjetikët që ndjekin qëllime agresive duan t’i kenë të siguruara prapavijat këtej nga Evropa. Ne, komentonte më tej ai, nuk bëjmë si rumunët që bërtasin, o burra të

---

<sup>21</sup> *Po aty*, f. 26.

<sup>22</sup> *AQSH*, F.14/AP, V. 1971, D. 5, f. 13, Nga biseda e Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut me ambasadorin kinez Liu Xhen Hua, në Tiranë, më 30 shtator 1971.

përfundojë sa më parë traktati mbi “sigurimin evropian”, që u lë dorë të lirë imperialistëve e revizionistëve të sulmojnë Kinën”<sup>23</sup>.

Nga retorika e udhëheqjes shqiptare të krijohet përshtypja se ajo po e refuzonte procesin e KSBE, për shkak se dëmtohej Kina. Por, kjo nuk ishte e vetmja arsye që kushtëzoi qëndrimin ndaj kësaj ideje. Mbështetja me zhurmë e qëndrimit të Kinës ndaj KSBE, në fakt ishte një biznes i mirë politik për udhëheqjen shqiptare. Po t’i shohësh me kujdes dhe vëmendje marrëdhëniet shqiptaro-kineze të kësaj kohe, do të vësh re se ato nuk ishin në stinën e tyre më të mirë. Udhëheqja shqiptare nuk e kishte pritur mirë takimin e Çu En Lait me Kosiginin në vitin 1969; kishte refuzuar propozimet e kinezëve për të krijuar një aleancë ndërmjet Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Rumanisë në Ballkan; ishte shprehur kundër takimeve paraprake të Henry Kissinger me udhëheqësit kinezë për përgatitjen e vizitës së ardhshme të Niksonit në Kinë etj. Ky qëndrim i udhëheqjes shqiptare do të reflektohej me “refuzimin diplomatik” të udhëheqjes kineze, e cila nuk dërgoi përfaqësuesit e vet në Kongresin VI të Partisë së Punës së Shqipërisë, në nëntor 1971<sup>24</sup>.

Në fakt, po t’i gjykosh më thellë shkaqet se pse udhëheqja shqiptare e refuzoi Konferencën e Helsinkit, do të dallosh se ato lidhen para se gjithash, me problemet që do të diskutonte konferenca e ardhshme, të cilat në tërësinë e tyre ishin të papranueshme për pushtetin komunist në vend, sepse mund të sillnin dobësimin e tij. Procesi i Helsinkit realisht u kthye në katalizator të lirisë në Evropë. Në të gjitha vendet e Evropës Lindore nën kontrollin sovjetik, u krijuan organizata që mbikëqyrnin qeveritë e vendeve të tyre, nëse këto po e zbatonin marrëveshjen e Helsinkit. Kissingeri është shprehur për dobinë e këtij procesi se ai “solli rrëzimin e Murit të Berlinit dhe shpërbërjen përfundimtare të Bashkimit Sovjetik”<sup>25</sup>. Veçanërisht i papranueshëm për qeverinë shqiptare, ishte propozimi amerikan për të përfshirë të drejtat dhe liritë e qytetarëve në përmbajtjen e saj. Pranimi i tyre do të cenonte “stabilitetin” e pushtetit komunist dhe do t’i hapte rrugë lindjes së fenomenit të disidencës dhe të disidentëve në Shqipëri, duke pasur si pikë referimi një vendim të pranuar nga qeveria. “Shporta e tretë”, siç dëshmoi koha u shoqërua me

<sup>23</sup> AQSH, F. 14/AP, V. 1971, D. 7, f. 7-8, Nga biseda e Enver Hoxhës me delegacionin ekonomik të RP të Kinës, të kryesuar nga FAN I, më 11 dhjetor 1971.

<sup>24</sup> Hamit Kaba, “Politika e SHBA në vitet 70 ...”, f. 206-207.

<sup>25</sup> Zëri i Amerikës, [www.zeriamerikes.com/content/a-30-2005-08-01-voa-7-855/9962/419291.html](http://www.zeriamerikes.com/content/a-30-2005-08-01-voa-7-855/9962/419291.html).

rezultate pozitive në disa prej vendeve ish-komuniste të Evropës Lindore e Qendrore. Shqipëria në këto vite, vazhdoi të ecte në rrugën e vet staliniste, ndërkohë që brenda vendit po zhvilloheshin fushata të forta spastruese dhe dënimesh në udhëheqjen e lartë të partisë, në sektorët e kulturës, ekonomisë dhe të mbrojtjes. Trendit liberalizues në vendet ish-komuniste, madje edhe në Kinë, udhëheqja shqiptare i kundërvuri spastrimet e forta dhe të ashpra.

Më 9 nëntor 1972, qeveria finlandeze, përmes një promemorje tjetër që u drejtoi diplomatëve të vendeve evropiane, amerikane e kanadeze, ftoi edhe qeverinë shqiptare, që t'i përcillte asaj listën me emrat e delegacionit shqiptar, të kryesuar nga shefi i misionit të saj në Helsinki, për të marrë pjesë në konsultimet multilaterale, që do të fillonin në këtë qytet, më 22 nëntor 1972<sup>26</sup>. Krahas promemorjes së qeverisë finlandeze, ambasadori i Danimarkës në Finlandë dhe njëkohësisht dekan i Trupit Diplomatik në Helsinki, do të ftone po në këtë datë, shefat e misioneve të vendeve evropiane, si dhe ata të SHBA dhe Kanadasë, që të merrnin pjesë në bisedimet shumëpalëshe, në lidhje me “mundësinë e mbledhjes së Konferencës mbi Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë”<sup>27</sup>.

Qeveria shqiptare ia përcolli përgjegjen e vet qeverisë finlandeze përmes një promemorje të veçantë, që ia adresoi ambasadës shqiptare në Vjenë, më 18 nëntor 1972. Një ditë më mbrapa kjo e fundit ia dorëzoi atë ambasadorit finlandez në kryeqytetin austriak<sup>28</sup>. Në këtë ditë Enver Hoxha do të shkruante në *Ditarin për Çështjet Ndërkombëtare*: “diskutuam dhe vendosëm për përgjigjen që Qeveria jonë do t'i dërgojë “promemories” së qeverisë finlandeze, e cila na fton të marrim pjesë në mbledhjen përgatitore, që do të mbahet në Helsinki, për “Konferencën e përgjithshme evropiane mbi sigurimin dhe bashkëpunimin. Ne e refuzojmë ftesën dhe arsyetojmë mospjesëmarrjen”<sup>29</sup>. Qeveria shqiptare, thuhej në promemorie “shprehet kundër mbajtjes së një konference mbi sigurimin evropian dhe nuk do të marrë pjesë në konsultimet shumëpalëshe lidhur me konferencën e përgjithshme evropiane mbi sigurimin dhe bashkëpunimin” që do të fillojë në Helsinki më 22

<sup>26</sup> AMPJ, V. 1972, D. 646, f. 77.

<sup>27</sup> Po aty, f. 75.

<sup>28</sup> Po aty, f. 79-86.

<sup>29</sup> Enver Hoxha, *Ditar për Çështje Ndërkombëtare (1972-1974)*, Tiranë: 1983, f. 316.

nëntor”<sup>30</sup>. Ajo i bënte të ditur qeverisë finlandeze se ishte shprehur me kohë për sigurimin evropian dhe në veçanti mbi mbajtjen e kësaj konference. Duke e konsideruar të justifikuar shqetësimin e popujve evropianë për sigurimin e vendeve të tyre, qeveria e Shqipërisë nuk e quante të arsyeshme pjesëmarrjen në Konferencë, sepse sipas saj nuk ekzistonin kushtet për thirrjen e saj, se ajo nuk do t’i shërbente zhvillimit dhe forcimit të një bashkëpunimi të frytshëm mbi bazën e barazisë, të mosndërhyrjes dhe të leverdisë reciproke për vendet evropiane. Udhëheqja komuniste e Shqipërisë përpiquej të argumentonte refuzimin e saj me “argumentet e mëposhtëm:

**Së pari**, Rreziku për popujt evropianë vinte nga dy superfuqitë, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik, si dhe nga “revanshizmi” gjermano-perëndimor. Superfuqitë sipas promemories, mbanin në këmbë dy blloqet më të mëdha ushtarake të kohës, NATO-n dhe Traktatin e Varshavës, ndërsa trupat e tyre ishin instaluar në vendet evropiane. Çekosllovakia vazhdonte të ishte e pushtuar nga ushtritë e Traktatit të Varshavës, ndërsa teoria e “sovrانيتit të kufizuar” ishte shndërruar në një parim themelor të politikës së BS, për të legalizuar sundimin mbi popujt e Evropës Lindore. Ndërsa SHBA, akuzohej për ndërhyrje politike dhe ekonomike në punët e brendshme të vendeve të Evropës Perëndimore, për bazat ushtarake në Evropë dhe për përpjekjet e saj, për t’u marrë vesh me BRSS. Udhëheqja shqiptare nuk shihte asgjë pozitive në aksionet diplomatike të dy superfuqive, për arritjen dhe përfundimin e marrëveshjes ndërmjet dy Gjermanive, të traktateve Bon-Moskë, Bon-Varshavë, Bon-Pragë, si dhe të marrëveshjeve katërpalëshe për Berlinin. Këto marrëveshje, sipas saj, kishin nxitur dhe forcuar tendencat revanshiste në Gjermaninë Perëndimore, “të cilën superfuqitë, po e bëjnë partnere të barabartë dhe fuqinë e parë në Evropë”<sup>31</sup>.

**Së dyti**, Qeveria shqiptare nuk e pranonte paqen në Evropë, “sepse paqja dhe siguri në Evropë dhe paqja dhe siguri në botë janë të pandara”. Për të argumentuar këtë ide silleshin shembuj nga konfliktet në Lindjen e Mesme, konflikti sovjeto-kinez për kufijtë. Qeverisë shqiptare nuk i pëlqente fakti që plani dhe procedura për thirrjen e konferencës, u konkretizuan dhe morën formë të plotë, pas bisedimeve sovjeto-amerikane të nivelit të lartë në Moskë. Për opinionin e saj, siguri në

<sup>30</sup> AMPJ, V. 1972, D. 646, f. 85.

<sup>31</sup> Po aty, f. 82.

Evropë do të thoshte të qetësoje prapavijat, për të drejtuar goditjen në zona dhe rajone të tjera të botës. Në thelb ky qëndrim nuk ndryshonte nga qëndrimi i udhëheqjes kineze.

**Së treti**, Konferenca e Sigurimit dhe e Bashkëpunimit në Evropë, nuk do të siguronte barazi për pjesëmarrësit e saj, dhe mundësi që ata të shprehnin pikëpamjet e tyre, se vendet pjesëmarrëse donin të siguronin prej saj përfitime ekonomike, politike, etj., por ata do të deziluzionoheshin shumë shpejt, se fuqitë e mëdha nuk do t'i respektonin angazhimet ndërkombëtare etj. Konferenca do të përhapte iluzionin e dëmshëm rreth paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, do të dobësonte vigjilencën e popujve evropianë dhe do t'i shërbente realizimit të qëllimeve hegjemoniste të dy superfuqive në Evropë. Në fund të promemories, qeveria shqiptare theksonte se ajo ishte për sigurimin dhe bashkëpunimin evropian, por të vendosur mbi bazën e parimeve të mosndërhyrjes, barazisë dhe respektit reciprok.

Kërkesat e qeverisë shqiptare ishin të paarrtshme, jo thjesht për natyrën e tyre virtuale, por edhe për arësyen e thjeshtë, se ajo nuk merrte pjesë në politikbërjen ndërkombëtare.

### **Konsideratat e qeverisë shqiptare ndaj KSBE dhe vendimeve të saj (korrik 1973-gusht 1975)**

Konferenca e Helsinkit i filloi punimet në kryeqytetin finlandez. Më 22 qershor 1973, në prag të hapjes së punimeve, qeveria shqiptare u ftua sërish nga qeveria finlandeze, që të merrte pjesë në të, por sërish ajo e refuzoi pjesëmarrjen, duke mbajtur në përgjithësi qëndrim kundërshtues dhe duke arsyetuar në të njëjtën mënyrë. Më 30 qershor 1973, ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Nesti Nase, i përcolli ambasadorit shqiptar në Paris, Dhimitër Lamani një promemorie të re, për t'ia dërguar qeverisë finlandeze. Ambasadori Lamani u ngarkua gjithashtu që këtë material t'ua përcillte disa ministrive të jashtme të shteteve të Evropës, agjencisë së lajmeve "Tanjug", "AFP" dhe disa korrespondentëve të huaj, që ai do ta shihte të arsyeshme<sup>32</sup>. Në të njëjtën ditë, zëvendësministri i Jashtëm i

<sup>32</sup> *Po aty*, V. 1973, D. 736, f. 2-4, Letër e Nesti Nases për Dhimitër Lamanin, Tiranë më 30 qershor 1973.

Shqipërisë, Reiz Malile, do të ritheksonte ambasadën shqiptare në Paris porositë e ministrit të Jashtëm<sup>33</sup>.

Në promemorian e re, qeveria shqiptare parashtrroi edhe njëherë qëndrimin e saj në lidhje me konferencën, duke theksuar se ajo nuk i shërbente aspak zgjidhjes së këtij problemi. Shkaktarët e pasigurisë për opinionin e udhëheqjes shqiptare ishin “organizatorët dhe iniciatorët e kësaj konference..., imperializmi amerikan dhe social-imperializmi sovjetik..”<sup>34</sup>, blloqet dhe bazat e ngritura prej tyre kudo në botë. Ajo i konsideronte të padobishme konsultimet paraprake gati njëvjeçare, për thirrjen e mbledhjes përfundimtare të KSBE dhe prej saj nuk pritej asnjë rezultat edhe në të ardhmen; konferenca ishte produkt i bashkëpunimit të dy superfuqive dhe ajo do të kontrollohej dhe manipulohet prej tyre. Konsultimet paraprake, qeveria shqiptare i quante të ideuara, drejtuara dhe zhvilluara nën peshën e presionit të dy të mëdhenjve, SHBA dhe BRSS. Sipas qeverisë shqiptare, në pamje të parë u ruajtën disa aparencat demokratike, por në realitet, nuk u respektuan parimet e barazisë dhe të shprehjes së vullnetit të lirë të shteteve pjesëmarrëse. Detantën që kishte filluar, në promemorie e quanin thjesht zhurmë propagandistike, ndërsa planin amerikan për një Kartë të re të Atlantikut - përgjigje ndaj kundërshtimeve të vendeve evropiane, me qëllim që imperializmi amerikan të forcojë kontrollin e tij në këtë zonë<sup>35</sup>. Qeveria shqiptare i konsideronte masat e marra në fillim të viteve 70, të monopolizuara nga dy superfuqitë dhe në interes të tyre. Për të, KSBE vetëm se do të legalizonte vendimet e marra në Washington e Kemp Dejvid, ndërsa paqja në Evropë do të mundësohej vetëm në sajë të një lufte të vendosur, të popujve evropianë, në radhë të parë, të luftës kundër superfuqive. Promemoria përfundonte me shprehjen, se qeveria shqiptare ishte kundër mbajtjes së Konferencës dhe se ajo nuk do të merrte pjesë në të<sup>36</sup>.

Pas kësaj periudhe nuk pati kontakte me qeverinë finlandeze, por në vend nuk pushuan kritikën kundër KSBE. Komentet rreth saj gjenden në ditarin personal të Enver Hoxhës, në bisedimet me delegacionet e huaja dhe sidomos me ata kinezë, në fjalimet elektorale dhe artikuj të botuar posaçërisht për këtë eveniment. Në këto materiale nuk sillen ndonjë

---

<sup>33</sup> *Po aty*, Telegram i Reiz Maliles për ambasadën shqiptare në Paris, nr. 1/1, Tiranë, 30.6.1973.

<sup>34</sup> *Po aty*, f. 5.

<sup>35</sup> *Po aty*, f. 7.

<sup>36</sup> *Po aty*, f. 9.

argument i ri, por përgjithësisht përsëriteshin tezat e mëparshme të artikuluara në disa raste me fjalë të tjera. Në fjalimin e tij elektoral, më 3 tetor 1974 Enver Hoxha do t'i rikthehej sërish problemit të sigurimit evropian. Ai shkruante: “ku qëndron siguri i popujve të Evropës ose i popujve të botës? Në udhëtimet e hapura dhe misterioze të njëfarë Kisingeri<sup>37</sup>, të njëfarë Gromikoje, apo në dallaveret e një Brezhnjevi, që gjakos popullin sovjetik dhe të tjerë...Këtyre do t'u lihet të sigurojnë të ardhmen e botës? E ardhme e bukur do të jetë?”<sup>38</sup>. Po në këtë fjalim Enver Hoxha u kthente përgjigje refuzuese ofertave të SHBA, BRSS, Britanisë së Madhe dhe RFGJ, për të vendosur marrëdhënie diplomatike me Shqipërinë. Dy të parat, ishin të përjashtuara, si dy shtete – superfuqi, Britanisë së Madhe i vihej si kusht kthimi i arit monetar shqiptar, RFGJ i kërkohet që të përmbushte kërkesën e qeverisë shqiptare për reparacionet që rridhnin nga Lufta e Dytë Botërore.

Enver Hoxha do të merrej me KSBE dhe në kohën kur ajo po i përfundonte punimet. Më 27 korrik 1975, ai do të porosiste Ramiz Alinë, që të botonin një artikull në gazetën “Zëri i Popullit”, dhe pastaj në përfundim të Konferencës së Helsinkit t’ua shpërndanin atë pjesëmarrësve të saj. Shpresohet, se ky artikull do të kishte jehonë ndër ta, me përjashtim të sovjetikëve, amerikanëve dhe Vatikanit. Ky i fundit, karakterizohet me fjalët se “udhëheq kopenë e berrave, që do të blegërijnë në haurin e “Betlehem Helsinkit”<sup>39</sup>. Artikulli i botuar në gazetën “Zëri i Popullit” më 29 korrik 1975, u titullua: “Konferenca e Pasigurisë së Evropës”. Si dhe në rastet e tjera, artikulohehin ide politike të njohura, por të përshtatura për shtypin e përditshëm. “Armiqtë” e vetëm të popujve vazhdonin të mbeteshin dy superfuqitë, të cilat u imponuan popujve të Evropës dokumentin e Helsinkit, duke pranuar status-kuonë e sotme të Evropës dhe zonat e tyre të influencës<sup>40</sup>. Konferenca e Helsinkit, sipas këtij artikulli, ndikonte negativisht për popujt e Evropës, sepse ajo përhapte frymën liberale-pacifiste, se “gjoja

<sup>37</sup> Henry Kissinger, ish Sekretar Amerikan i Shtetit, kreu disa udhëtime të fshehta për t'u takuar me udhëheqësit kinezë, në vitin 1971 dhe 1972, duke përgatitur vizitën e presidentit Nikson të SHBA në Kinë, në shkurt 1972; Gromiko ish ministër i Jashtëm i BRSS dhe Leonid Brezhnjevi - kryetar i Presidiumit të Sovjetit Suprem të BRSS.

<sup>38</sup> *Zëri i Popullit*, nr. 238 (8156), Tiranë, 4 tetor 1974.

<sup>39</sup> E. Hoxha, *Ditar për Çështje Ndërkombëtare...*, f. 125.

<sup>40</sup> *Zëri i Popullit*, Tiranë, 29 korrik 1975.

të gjitha problemet botërore, konfliktet klasore ndërkombëtare, mund të zgjidhen me anë të bisedimeve “paqësore” e “kontakteve personale”, se, krerët e tanishëm sovjetikë e amerikanë janë njerëz të paqes e punojnë për paqen<sup>41</sup>. Në artikull për politikën e uljes së tensionit shkruhej: “E ashtuquajtura politikë e uljes së tensionit, për të cilën tani bëjnë shumë zhurmë imperialistët amerikanë dhe social-imperialistët sovjetikë, është vazhdim i Luftës së Ftohtë, por në një formë tjetër, është politika e vjetër e forcës, por e maskuar me buzëqeshje e nanurisje<sup>42</sup>”.

Më 31 korrik 1975, në ditarin e tij personal, Enver Hoxha do të merret sërish me KSBE. Ai i kushton disa faqe mbajtjes së saj, përsërit teza të njohura por të veshura me frazeologji dhe me një gjuhë metaforike. “Në Konferencën e Helsinkit, shkruan ai, u kërcye valle më shumë se dy vjet me radhë për të “pjellë mali një mi<sup>43</sup>”. Në të, nuk kursehen kritikrat dhe talljet për burrat evropianë dhe amerikanë të shtetit. Sipas E. Hoxhës, BRSS përpiqen të evitojnë goditjen atomike nga ana e amerikanëve dhe se ekonomia e tyre është e dobët. Lëshimet e sovjetikëve sipas Hoxhës, janë të kushtëzuara nga kërkesat e tyre për teknologji nga SHBA dhe nga Perëndimi. Ndërsa, SHBA dhe Perëndimi kërkojnë të penetrojnë në vendet e Evropës Lindore dhe në BS, nëpërmjet ideve dhe njerëzve të tyre, për t’i “krimbur” ata nga brenda. Gjithashu, Perëndimi synon të shtojë antisovjetizmin brenda vendeve të Evropës Lindore, ndërkohë satelitët e BS do të përpiqen të dalin nga “dhokani” i tij. “Brezhnjevi, Fordi, Zhiskari dhe Shmidi, shkruan Hoxha, bëjnë mbledhje për “Berlinin Perëndimor”, por ky është “gishti” nga u kapën perëndimorët, kur Bashkimi Sovjetik u bëri atyre koncesionet e njohura, për të kapur krahun, bashkimin e dy shteteve gjermane<sup>44</sup>”.

Këto analiza të Enver Hoxhës, përputheshin vetëm pjesërisht me ato të udhëheqjes së lartë kineze, shtetit dhe aleatit të ngushtë të Shqipërisë. Kinezët nuk e mbështetën KSBE, duke e konsideruar atë një mjet të sovjetikëve për të pasur duart të lira nga Evropa, dhe për t’u angazhuar në Lindjen Aziatike, dhe veçanërisht në Kinë, ku ata kishin të vendosura mijëra trupa në kufijtë e dy vendeve. Por, udhëheqja kineze ishte më realiste dhe më e matur se ajo shqiptare. Ajo kishte filluar rrugën e

<sup>41</sup> *Po aty.*

<sup>42</sup> *Po aty.*

<sup>43</sup> E. Hoxha, *Ditar për Çështje Ndërkombëtare...*, f. 8, “Konferenca e Helsinkit – Një lojë internale pa shpresa”, më 31 korrik 1975, f.127.

<sup>44</sup> *Po aty*, f. 131-132.

përmirësimit të marrëdhënieve me SHBA, ndërsa këto të fundit ishin shprehur se do të mbështesnin Kinën, në rast të një sulmi të BRSS mbi të. Gjithashtu, nuk e shihnin bashkimin e dy shteteve gjermane si një akt të shpejtë, dhe sipas tyre BS nuk do të lëshonte pe në këtë pikë. Kina kishte filluar të bënte një politikë globale, ndërsa brenda vendit kishte filluar një proces ndryshimesh graduale. Politika e udhëheqjes shqiptare, përkundrazi vazhdoi me skemat e saj të vjetra, që nuk i shërbenin vendit dhe zhvillimit të tij.

### *S u m m a r y*

#### THE CONFERENCE ON SECURITY AND CO-OPERATION IN EUROPE (CSCE): A MISSED CHANCE FOR ALBANIA

The focus of this article is an event that has not been dealt before in the Albanian historiography, namely the refusal by the Albanian communist leadership to participate in the Conference on Security and Co-operation in Europe (CSCE nowadays OSCE), in the first half of the 1970s. This research paper is organized in three parts: it makes a short overview of the history of CSCE's creation; then it gives the Albanian government's attitude during the preparatory phase of the Conference, and finally, its refusal to participate in the meeting where CSCE was founded.

In this article the author aims to deal with an issue of Albania's foreign policy during the first half of the 1970s and portrays it from the local and international point of view. In this short article are highlighted the real reasons that defined the Albania's leadership refusal to participate in the Helsinki Conference.

A key factor in shaping the Albanian position is considered to have been the influence of the Chinese leadership which considered the CSCE as a coalition that would guarantee the security of the European continent at the expense of the Asian continent, and more specifically at the expense of China. However, the refusal of the Albanian leadership came also as a result of the decisions of CSCE, especially the third provision which included the recognition of human rights and liberties. The implementation of this article would weaken the power of the Albanian leadership within the country as it would create favorable conditions for dissidence and dissidents who would cause the decay of the

system from within, just as it happened in the other ex-communist countries of Europe.

The primary sources used in writing this article are mainly Albanian documents, especially those found in the Foreign Ministry Archive, the works of Enver Hoxha, Albanian newspaper articles, internet sources and several foreign publications.